



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.11.2020, ora 14.30

Drejton mbledhjen -

Vitore Tusha – Zv.Kryetare e Këshillit

Rendi i Ditës :

- 1. Miratimi i procesverbalit të përmbledhur të mbledhjes të KED-së të datës
05.10.2020**

Marrin pjesë :

- | | |
|-------------------|--------------------|
| 1. Vitore Tusha | (zëvendëskryetare) |
| 2. Arta Marku | (anëtare) |
| 3. Miranda Andoni | (anëtare) |
| 4. Saida Dollani | (anëtare) |
| 5. Fatjona Memçaj | (anëtare) |
| 6. Ludovik Dodaj | (anëtar) |

Merr pjesë, si vëzhgues i përhershëm :

1. Avokati i Popullit, përfaqësuar nga z. Enio Haxhimihali.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Znj. Katrin Treska përfaqësuese e Presidentit të Republikës, përfaqësuar nga autorizimi nr. 446 prot, datë 29.01.2020.
2. Znj. Mimoza Arbi, përfaqësuese e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

HAPET MBLEDHJA

Vitore Tusha - Atëherë hapim mbledhjen e thirrur për sot që lidhet me miratimin e proces verbaleve të mbledhjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të datës 05.10.2020. Siç ju kam informuar dhe keni dijeni gjatë kohës fundit të javës që shkoj pas thirrjes së kësaj mbledhje kemi arritur të përmbledhim dhe proces verbalin e datës 9.10.2020, kjo për arsye se një pjesë e mirë e stafit administrativ, shumica e stafit administrativ mungojnë me arsye shëndetësore. Pra ka pasur një kufizim të numrit të personelit administrativ në veprimtarin e përditshme por arritëm të realizojmë brenda afateve edhe përmbledhjen dhe vënien në dijeni, dhënien e afatit të duhur sipas aktit të brendshme të gjithë anëtarve të këshillit dhe të ftuarve në mënyrë që të plotësohet ai rregull prej 48 orësh dhe të miratojmë në mbledhjen e sotme edhe proces verbalin e datës 9.10.2020. Arsyen përse e thirrem mbledhjen të shkëputur ose e thirrem mbledhjen vetëm për miratim proces verbalit lidhet me aktin se Gjykata e Apelit është duke shqyrtuar disa ankesa të disa kandidatëve që ne kemi shqyrtuar, dhe për të cilët kemi vendosur ndalim, ka vendosur ka kërkuar nga KED paraqitjen e proces verbalit përkatës që lidhet me kandidatët që kanë paraqitur paditë. Në përputhje me ligjin ne kemi dy, një proces verbal ose një regjistrim audio që është që mund ta quajmë aktin me origjinal dhe kemi një proces verbal të përmbledhur si akt që duhet të miratohet dhe me pas të publikohet i cili ka vlerën e proces verbalit të përmbledhur në përputhje me kërkesat e neneve 232 pika 2 dhe 226, ku flet për kompetencat e kryetarit mënyrën se si duhet të përkujdeset për të garantuar këto dy mënyra të pasqyrimin të mbledhjes së KED-ës. Unë ju bëj me dije për prezencën që anëtarja Fjona Papajorgji ka lajmëruar që në mëngjes që për arsye shëndetësore nuk mund të jetë e pranishme në mbledhjen e sotme, dhe po jua lexoj në mënyrë të plotë ; Për arsye shëndetësore nuk mund të marrë pjesë në mbledhjen e sotme të KED-ës dhe ndërkohë me anë të këtij e-mali konfirmoj se jam dakord me miratimin e proces verbaleve të përmbledhura të datës 05.10.2020 dhe datës 09.10.2020. Sepse njëllor me të gjithë anëtarët e tjerë i është shpërnda dhe ka dhënë sugjerimet e saj në mënyrën e përmbledhjes dhe ka shprehur dakortësin. Para se tju ftoj për ta miratuar proces verbalin e përcaktuar në rendin e ditës, ftoj të shprehni qëndrimin dhe në lidhje me miratimin e proces verbalit për datën 09.10.2020 pasi nuk jua kam prezantuar por siç thash kemi dijeni, dhe në rregullore këtë fazë e kemi të parashikuar dhe në rastet kur nuk janë pjesë e rendit të ditës ato kalon si çështje e parë. Megjithatë pavarësisht kësaj unë kërkoj këtë dakortësi të shprehur prej jush. Pra qoftë me përfshirjen e miratimit të proces verbalit të datës 9.10.2020 në temë dite dhe miratimet përkatëse për të dy

proces verbalet nëse do të biem dakord, kërkoj dy dakortësi në këtë procedurë. Atëherë janë të pranishëm në këtë mbledhje edhe përfaqësuesja e Presidentit Zj. Katrin Treska dhe përfaqësuesja e Kryetarit të Kuvendit Zj Mimoza Arbi dhe përfaqësuesi i Avokatit të Popullit Z. Enio Haxhimihali. Ka ndonjë pyetje paraprakisht ?

Pyetje nuk ka . Atëherë fjala për ju Zj. Marku.

Arta Marku - Faleminderit. Jam dakord të përfshirjen në mbledhje dhe përmbledhja e proces verbalit të mbledhjes së datës 09.10.2020 dhe jam dakord për miratimin e të dy proces verbaleve si ai i datës 05.10.2020 dhe datës 09.10.2020.

Vitore Tusha - Faleminderit Zj Andoni.

Miranda Andoni - Jam dakord të përfshihet në rendin e ditës dhe proces verbalit i datës 09.10.2020 ndërkohë miratoj ashtu siç na janë paraqitur të dy proces verbalet si të datës 05.10.2020 dhe datës 09.10.2020.

Vitore Tusha - Faleminderit Zj. Dollani.

Saida Dollani – Atëherë unë jam shumë dakord me çfarë u tha me përpara të miratohen të dyja proces verbalet sepse dhe ky i datës 09.10.2020 na është sjell e kam lexuar jam dakord.

Ludovik Dodaj – Dakord me të dy proces verbalet të datës 05.10.2020 dhe datës 09.10.2020.

Fatjona Memçaj – Dakord dhe me ndryshimin e rendit të ditës dhe përfshirjen në rendin e ditës të miratimit të proces verbalit të datës 09.10.2020 dakord me përmbajtjen e të dy proces verbaleve jam njohur me përmbajtjen e tyre siç na është dërguar në rrugë elektronike dhe jam dakord me miratimin .

Vitore Tusha - Faleminderit, sic ju pyeta paraprakisht nuk kemi diçka. Po Enio.

Enio Haxhimihali - Ne e kemi dërguar aprovimin tonë por do rekomandonim në rastet kur nga anëtarët apo nga të ftuarit e tjerë ka rekomandim për ndryshim proces verbalit dhe ato merren parasysh së pari kjo gjë të informohet dhe nëse varianti i dytë ndryshon nga i pari të rishpërndahet edhe njëherë. E dyta në lidhje me informacionin që ju dhatë për miratimin online po e quaj që ka dhënë anëtarja e cila është sot në mungesë Zj Papajorgji nisur dhe nga periudha e pandemisë mbase ta diskutoni duke parë të nevojshme që në rregulloren tuaj të përfshini nene për votimin online këto dy çështje doja të sqaroja për momentin. Faleminderit.

Vitore Tusha - Faleminderit dhe ju nëse do të ishte një mbledhje me rend dite që do kishim çështje datoj që është kompetencë e kësaj mbledhje unë sigurisht do të lajmëroja antarin zëvendësues. Por duke qenë tipike e miratimit të proces verbaleve e konsultova dhe me antarin zëvendësues sepse proces verbalit është një akt i cili do nënshkruhet nga ata që kanë qenë pjesë e mbledhjes. Në këtë kuptim sa kohë që dhe kuorumi ishte i pa cenuar në këtë rast vlerësuam në këtë formë.

Enio Haxhimihali - Kjo ishte arsyeja pse erdha unë dhe jo avokatja, nga që kisha qenë unë herët e kaluara kam qenë unë .

Vitore Tusha - Rekomandimin që ju thoni do ta marrim në konsideratë, lidhur me një sugjerimin tuaj unë në përmbledhje e proces verbalit nuk kam pasur deri më sot as njëherë as një kontest që lidhet me ju të ftuarve nuk ju është cenuar as gjë nga ajo që keni thënë dhe keni dijeni. Dhe një redaktim i natyrës gramatikore është bërë në bashkëpunim në mirëkuptim ska pas as një kontest për mënyrën por çdo lloj mënyre prandaj është i hapur edhe në momentin e fundit, jo pa qëllim ju solla dhe të datës 5.10.2020, ndërkohë që ne procedurën e kishim bërë që kohë me parë. Atëherë nëse nuk kemi as një gjë tjetër të dy sipas votimit të dy proces verbalet u miratuan si proces verbali i datës 05.10.2020 ashtu dhe proces verbali i datës 09.10.2020. Kështu që e deklaroj mbledhjen e mbyllur.

Sekretare

Vilma Dokushi

Zëvendëskryetare

Vitore Tusha